



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 803/4 Prot.

Tiranë më 07.06.2019

VENDIM

Nr. 15, datë 07.06.2019

PËR KONTROLLUESIN "KLINIKA DAVINÇI"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit *Klinika "DaVinçi"*,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.160, datë 22.05.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 28.05.2019 u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit *Klinika "DaVinçi"*, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit *Klinika "DaVinçi"*, konstaton se:

1. Kontrolluesi, ka "*Njoftuar*" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22, të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar. Njoftimi është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore që duhet të përmbush Kontrolluesi, përpara se të përpunojë të dhëna për herë të parë, pra që në momentin e fillimit të aktivitetit.
2. Kontrolluesi, ka një Rregullore specifike për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e sigurisë e të dhënave personale, të përshtatur me aktivitetin e klinikës në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar. Duke hartuar një rregullore të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, si një akt bazë, kontrolluesi ndërgjegjëson dhe sqaron punonjësit për të dhënat personale, rëndësinë e tyre, ruajtjen e fshehtësisë si dhe mënyrën e administrimit të tyre.

Kontrolluesi, *Klinika "DaVinçi"*, ka marrë masa konkrete për ruajtjen dhe sigurinë fizike të dosjeve të pacientëve në ambiente të kyçura, duke marrë masa të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar.

3. Kontrolluesi, ka nënshkruar "*Deklaratë Konfidencialiteti*", në zbatim të Vendimit nr.06/2013, të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*", me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.

Qëllimi i nënshkrimit të kësaj deklarate është fakti që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në informacione lidhur me të dhënat personale, të tyre apo të klientëve, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë për ruajtjen e konfidencialitetit.

4. Kontrolluesi ka një sistem video-survejimi (CCTV), të përbërë nga 4 kamera. Kontrolluesi ka vendosur një tabelë informuese në një cep të sallës ku bëhet pritja e pacientëve, por vendosja e tabelës ndodhet në një pozicion të papërshtatshëm dhe nuk bën të mundur informimin e qytetarëve, të cilët janë të monitoruar që në hyrje të klinikës për praninë e sistemit të video-survejimit, në kundërshtim me nenin 18, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar dhe në Udhëzimin nr.3/2010 të Komisionerit, ku në gërmën dh), të pikës 4, parashikohet: "*Subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem të videoregjistrimit është në veprim, duke vendosur njoftimin e shkruar në hapësirën e monitoruar ...*".

Gjithashtu, tabelat informuese të përdorura nga kontrolluesi nuk janë sipas standardit të parashikuar në Udhëzimin nr.03/2010, të Komisionerit. Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë etj.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 300.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

5. Kontrolluesi nuk ka vendosur politikën e privatësisë me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë portalin [www.davinci.al](http://www.davinci.al). Informacioni i publikuar në "*Politikën e Privatësisë*", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 300.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

Ndaj Kontrolluesit *Klinika "DaVinçi"* është kryer më parë hetim administrativ, ku me **Vendimit nr.02, datë 10.03.2016 të Komisionerit**, është vendosur:

1. Dënimi i kontrolluesit *Klinika "DaVinçi"*, me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetëmijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar;
2. Dënimi i kontrolluesit *Klinika "DaVinçi"*, me gjobë në vlerën 30.000 (tridhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 dhe 28, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar;
3. Kontrolluesi *Klinika "DaVinçi"*, të rikuperojë shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit, brenda një periudhe prej 30 ditësh, ku përparësi merr rregullorja, e cila duhet të hartohet sipas standardeve të përcaktuara në aktet e Komisionerit.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin e konstatimit, datë 28.05.2019, i cili u lexua dhe u nënshkrua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit u shprehën se: "*Unë i nënshkruari Arbri Faria përfaqësuesi i Klinikës "DaVinçi" nuk jam plotësisht dakord me pikën 3 dhe 4 të procesverbalit. Do ju sjell nëpërmjet e-mail pretendimet tona*".

Në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", kontrolluesi *Klinika "DaVinçi"* është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, në datën 05.06.2019, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit. Kontrolluesi është paraqitur në seancën dëgjimore, ku ka paraqitur edhe pretendimet me shkrim se:

*"Lidhur me shkresën që ju keni plotësuar në zyrat tona për atë që është konstatuar gjatë inspektimit administrativ duam t'ju vëmë në dijeni se për pikat 3 dhe 4 janë marrë masat për korrigjimin e menjëhershëm të tyre:*

- *Njoftimi për survejimin e ambientit me kamera u modifikua sipas kërkesave tuaja si në foton bashkëngjitur këtij e-maili.*
- *Gjithashtu në web-site [www.davinci.al](http://www.davinci.al) u vendos dritarja komunikuese për Politikën e Privatësisë, ku shfaqet gjithë informacioni mbi mbrojtjen e privatësisë sikurse e parashikon ligji. Kjo dritare ishte publikuar vetëm në njërin prej faqeve te web-it, ndërkohë që tani shfaqet në të gjitha."*

Në shkresat e paraqitura në seancën dëgjimore dokumentohet rikuperimi i shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë kontrolluesit. Reagimi i shpejt i Kontrolluesit është marrë parasysh në caktimin e masës së sanksionit, megjithatë **Kontrolluesi duhet të kishte marrë masa për zbatimin e detyrimeve ligjore që në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit.**

Kontrolluesi *Klinika "DaVinçi"*, në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar, është person juridik dhe sipas nenit 39/2, të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*"

i ndryshuar, për kundërvajtjet e mësipërme dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin se shkeljet e konstatuara qëndrojnë. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Megjithatë, është marrë në konsideratë fakti që kontrolluesi është treguar bashkëpunues me grupin e kontrollit, ka reaguar pas konstatimit të shkeljeve si edhe ka përmbushur detyrimet për kërkesat ligjore, duke ndikuar në përcaktimin proporcional të masës së sanksionit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 18, 29, 30, 39 pika 1 gërma "b" si dhe nenet 40 dhe 41, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e kontrolluesit *Klinika "DaVinci"* me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve, përsa i përket informimit të subjekteve të të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, nëpërmjet "*Politikës së Privatësisë*" në portalin zyrtar [www.davinci.al](http://www.davinci.al) parashikuar në nenin 18, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
3. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 7.06.2019

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

